



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.162, datë 05.07.2022

PËR

**“CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATËT QË KA KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, I SHPALLUR ME VENDIMIN NR.153, DATË 27.06.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenet 159 pika 1, 161 dhe 190 pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në pikat 2-7 të nenit 32 dhe pikat 7-8 të nenit 48, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pasi u njoh me relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, për caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.153, datë 27.06.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.153, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
  1. Ilir Hoxha, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, Relator, zoti Zeqir Hoda.
  2. Kledian Llaho kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, Relator, zoti Ludovik Dodaj.



- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- III. U shpall në Tiranë, sot më 05.07.2022.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**

**Alfred Balla**

**ZV/KRYETAR**

**Tartar Bazaj**

**ANËTAR**

**Sokol Stojani**

**ANËTAR**

**Bujar Sheshi**

**ANËTAR**

**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**

**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**

**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**

**Ludovik Dodaj**

**ANËTAR**

**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**

**Mirela Bogdani**